



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT BERAT

Nr. 859/8 Prot.

Berat, më 11.10.2021

VENDIM

Nr. 18, datë 08.10.2021

PËR

PROPOZIM PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z.  
GËZIM MYQEREM DOKO

Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 5 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit nr. 429, datë 12.09.2002 të Këshillit të Ministrave "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurat e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar me Vendimin nr. 730, datë 02.09.2015 të Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në Vendimin nr. 429, datë 12.09.2002, "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurat e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" pas shqyrtimit të kërkesës së z. Gëzim Myqerem Doko dhe dokumentacionit shoqëruar për përfitim Shtesë Pensioni të Posaçëm Shtetëror,

VENDOSI:

1. T'i propozohet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhënien e Shtesës së Pensionit të Posaçëm Shtetëror Z. Gëzim Myqerem Doko, për arritje të rezultateve të dallueshme në procesin mësimor - edukativ.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e këshillit të Qarkut Berat.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 78 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

KRYETAR

Donald MOLLISHTI



Këshilltar gjithsej: 18

Morrën pjesë në votim: 13

Votuan Pro: 13

Këshilli i Qarkut Berat, Blvd."Republika"; Fëb: [www.qarkuberat.gov.al](http://www.qarkuberat.gov.al)

E-mail: [info@qarkuberat.gov.al](mailto:info@qarkuberat.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT BERAT

SEKTORI JURIDIK BURIMEVE NJERËZORE INFORMIMIT DHE STATISIKAVE

Nr. 859/Prot  
/4

Berat më, 30.09.2021

RELACION

“PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Z. GËZIM MYQEREM DOKO

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Qarkut Berat.

Pranë Këshillit të Qarkut Berat është depozituar kërkesa e z.Gëzim Myqerem Doko, administruar me nr. 798 Prot, datë 20.09.2021, për shtesë Pensioni të Posaçëm Shtetëror të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë e datës 20.09.2021 për përfitim shtesë/ pensioni të posaçëm shtetëror e shoqëruar me CV personale të z. Kopje e noterizuar i Titullit “Naim Frashëri” nga Presidiumi i Kuvendit Popullor Z.Gëzim Myqerem Doko
2. Vërtetim me nr. 449 Prot, datë 14.09.2021 i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Berat
3. Certifikatë Familjare
4. Kopje e dokumentit të Identifikimit

Sa më sipër depozitimi i kësaj kërkesë gjen mbështetje dhe është e parashikuar në shkronjën “b” të nenit 5 “Pensionet Shtetërore të Posaçme” të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në të cilin sanksionohet se:

1. *“Kanë të drejtë për pension të posaçëm që jepen nga shteti ndër të tjera personat që: “Kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës” dhe vijon:*

*Personat përfitues sipas këtij neni përfitojnë:*

- a) *Pension të posaçëm shtetëror, në rast se nuk përfitojnë pension nga sigurimet shoqërore, ose*
- b) *Shtesë pensioni të posaçëm shtetëror mbi pensionin që u takon nga sigurimet shoqërore.*

Kërkesa e sipërcituar vjen në mbështetje edhe të Vendimit nr. 429, datë 12.09.2002 të Këshillit të Ministrave "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurat e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar me Vendimin nr. 730, datë 02.09.2015 të Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në Vendimin nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurat e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" në të cilin sanksionohet:

Në pikën 1 të VKM-së së sipërcituar përcaktohet:

1. Se kush përfiton Pension të posaçëm shtetëror ose shtesë pensioni të posaçëm shtetëror sipas të cilit e përfitojnë personi që plotëson kushtet e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "c" të nenit 5 "Pensionet Shtetërore të Posaçme" të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Në vijim në pikën 2 të VKM-së së sipërcituar përcaktohet:

1. Se mosha dhe vjetërsia në punë për përfitimin e pensionit të posaçëm shtetëror janë ato të përcaktuara në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Në vijim në pikën 4 të VKM-së së sipërcituar përcaktohet:

1. Se kërkesa për përfitimin e pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror bëhet nga i interesuari ose organizatat a shoqatat, nëpërmjet këshillit të qarkut të vendbanimit të personit të propozuar, ministrave përkatës, Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit ose Presidentit dhe se Këshilli i Qarkut, Ministri, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit ose Presidenti, pasi shqyrtojnë kërkesën dhe dokumentacionin shoqëruar, i propozojnë Këshillit të Ministrave, me vendim të argumentuar, dhënien e pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesë pensioni të posaçëm shtetëror.

Në vijim në pikën 5 të VKM-së së sipërcituar përcaktohet:

1. Propozimi që paraqitet në Këshillin e Ministrave për përfitimin e pensionit të posaçëm shtetëror ose shtesë pensioni të posaçëm shtetëror shoqërohet me :
  - a) Kërkesën e të interesuarit, të shoqatës a të organizatës, e cila duhet të përmbaj gjeneralitetet; emër atësi, mbiemër, datëlindjen, vendlindjen etj.
  - b) Vendimin e institucionit propozues (në rastin e propozimit të drejtpërdrejtë gjeneralitetet jepen në vendim) të shoqëruar me relacionin, i cili argumenton arsyet e propozimit dhe procedurën e ndjekur etj.
  - c) Vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore nëse përfiton ose jo pension nga sigurimet shoqërore dhe nëse përfiton vërtetim mbi masën e tij.
  - d) Certifikatën e gjendjes civile.

- e) Kopjen e noterizuar e dokumenteve, që vërtetojnë meritat e veçanta të personit për të cilin bëhet propozimi, si titujt, medaljet, urdhrat etj.

Juristi

Hyrije Zeqaj

